



*Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo Regionalnog Razvoja  
Ministry of Regional Development*

## **THIRRJE PËR PJESËMARRJE - "E DUA RAJONIN TIM"**

### **KONKURSI FOTOGRAFI DHE VIDEO PROMOVUES PËR RAJONET ZHVILLIMORE TË KOSOVËS**

**15 Shkurt – 15 Mars, 2024**

#### **THIRRJE PËR APLIKIM**

Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bashkëpunim me UN-Habitat Kosovë dhe me mbështetje të Qeverisë së Suedisë, po organizon konkursin e parë të fotografisë dhe videos me temën "E dua rajonin tim". Objektiva primare e këtij konkursi është të identifikoj asetet dhe potencialet – njerëzore, ekonomike, dhe natyrore – në çdo rajon zhvillimor të Kosovës. Këto foto dhe video do të shërbejnë që të promovojnë këto rajone dhe të inspirojnë ide investimesh të reja të cilat do të përmbajnë një zhvillim të balancuar dhe qëndrueshëm rajonal.

Ne i ftojmë fotografët, profesional dhe amatorë, si dhe krijuesit e videove, të marrin pjesë në këtë konkurs fotografie dhe video. Participantët janë të inkurajuar të kapin mundësi të gëzueshme, momente dhe potenciale, duke theksuar aspektet pozitive, shembujt e mirë, dhe shpirtin vibrant të 7 rajoneve të Kosovës. Për këtë konkurs, personat që hyjnë kanë opsionin të zgjedhin në mes të dy kategorive të bashkangjitura:

#### **1. Kategoria 1 (C1) – Fotografia**

Fotot e dorëzuara në këtë kategori duhet ti përshtaten kriterëve specifike të shënuara në kushtet e aplikimit më poshtë. Secila foto duhet të reprezentoj një nga 7 rajonet zhvillimore të Kosovës, duke u përafëruar me 10 temat e definuara. Participantët janë të inkurajuar të tregojnë esencën unike të rajonit të tyre të zgjedhur duke i identifikuar dhe nxjerrur në pah potencialet njerëzore, ekonomike, dhe natyrore të secilit rajon. Temat e zgjedhura janë:

1. Natyrë dhe Ambient
2. Trashëgimi Kulturor dhe Tradita
3. Libra dhe Botime
4. Gastronomi
5. Ngjarje dhe Festivale Artistike
6. Turizëm, Sport dhe Rekreacion
7. Arkitekturë
8. Planifikim Hapësinor dhe Urban
9. Ekonomi dhe Industri
10. Njerëz (të vjetër dhe të rinjë) në përditshmëri

#### **2. Kategoria 2 (C2) – Video**

Kjo kategori i fton participantët të shprehin vizionet e tyre kreative përmes tregimit të ngjarjeve me video. Personat që hyjnë janë të inkurajuar të dorëzojnë video magjepsëse që nxjerrin në pah potencialet njerëzore, ekonomike, dhe natyrore brenda një nga 7 rajoneve zhvillimore të

Kosovës, duke u përafuar me 10 temat e definuara. Videot duhet të përshtaten me kriteret specifike të shënuara në kushtet e aplikimit më poshtë. Temat e zgjedhura janë:

1. Natyrë dhe Ambient
2. Trashëgimi Kulturor dhe Tradita
3. Libra dhe Botime
4. Gastronomi
5. Ngjarje dhe Festivale Artistike
6. Turizëm, Sport dhe Rekreacion
7. Arkitekturë
8. Planifikim Hapësinor dhe Urban
9. Ekonomi dhe Industri
10. Njerëz (të vjetër dhe të rinjë) në përditshmëri

Secila foto duhet të përfaqësojë një nga rajonet zhvillimore të Kosovës:

1. **Rajoni i Prishtinës:** Glogoc/Drenas, Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Graçanicë.
2. **Rajoni i Mitrovicës:** Mitrovicë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok, Zvečan.
3. **Rajoni i Pejës:** Decan, Istog, Klinë, Pejë.
4. **Rajoni i Prizrenit:** Dragash, Prizren, Suharekë, Mamushë.
5. **Rajoni i Ferizajit:** Kacanik, Shtime, Shtërpçë, Ferizaj, Hani i Elezit.
6. **Rajoni i Gjilanit:** Gjilan, Kamenicë, Novobërd, Viti, Ranillug, Partesh, Kllokot
7. **Rajoni i Gjakovës:** Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik.



## AFATI KOHOR

Afati kohor për dorëzim është nga **15 Shkurt** deri më **15 Mars, 2024**.

Shpallja e fotove dhe videove fituese do të vendoset para konferencës së Zhvillimit Rajonal dhe të selektuarit do të publikohen aty. Për datën e konferencës do të njoftoheni me kohë.

Fotot dhe videot duhet të dorëzohen në këtë e-mail adresë: [zhvillimirajonal@rks-gov.net](mailto:zhvillimirajonal@rks-gov.net).

## KUSHTET E PJESËMARRJES

Të përgjithshme:

- Duke pranuar këto kushte, pajtoheni të veproni në përputhje me to dhe pranoni se i keni lexuar dhe kuptuar të gjitha kushtet këtu! Nëse nuk pajtoheni, nuk mund të merrni pjesë në këtë konkurs.

---

### PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS

Objekti i Minsitrisë "Rilindja", Kati i 10, Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 38 200 32611, [office@unhabitat-kosovo.org](mailto:office@unhabitat-kosovo.org)

Një program i implementuar nga:



dhe i ko-financuar nga:



- E lironi plotësisht Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe UN-Habitat Kosovo nga pretendimet e palëve të treta, mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, për fotografitë dhe videot që do të ngarkohen në faqe nga ju.
- Fotot dhe videot e ngarkuara duhet të jenë realizuar brenda dy viteve të fundit dhe duhet të kenë një frymë pozitive.
- Nëse në fotografi dhe video janë imazhe të personave të tjerë, ju mbani përgjegjësinë për përdorimin e tyre.
- Fotot ose videot që promovojnë diskriminim racor, gjinor, nuditet, etj., do të përjashtohen automatikisht nga procesi i vlerësimit.
- Fotot dhe videot duhet të jenë ekskluzivisht me imazhe të Kosovës duke i përbajtur kategorive të përcaktuara.
- Nëse fotot dhe videot nuk përputhen me kriteret e përshkruara, Ministria rezervon të drejtën që të reduktoj numrin e çmimeve.

#### Kritere Artistike:

- Fotografitë dhe videot duhet të paraqesin perspektiva dhe këndvështrime të reja.
- Duhet krijuar thellësi dhe dimensione.
- Duhet pasqyruar kompozime artistike dhe krijuese që ndikojnë vizualisht.
- Duhet përshkruar traditat kosovare me elegancë.
- Duhet theksuar bukuria natyrore e peizazheve kosovare.
- Imazhet duhet të ngjallin emocione dhe tregojnë histori, duke evidencuar vlerat e rajoneve zhvillimore të Kosovës.
- Videot duhet të shprehin kreativitet, inovacion dhe origjinalitet.

#### **KRITERET E DORËZIMIT**

##### Pranueshmëria:

- Pjesëmarrësit kanë të drejtë të dorëzojnë maksimum 4 foto, secila e ndryshme nga një nga 10 temat. Fotot e tepërta nuk do të merren në konsideratë, por vetëm katër të parat të paraqitura do të përfshihen në konkurs.
- Pjesëmarrësit kanë të drejtë të dorëzojnë maksimum 2 video nga një nga 10 temat, videot e tepërta nuk do të merren në konsideratë, por vetëm dy videot e para të paraqitura do të përfshihen në konkurs.

##### Kritere Teknike për Fotot:

- Fotot duhet të jenë 4 megapiksel ose më shumë.
- Të jenë të ruajtura në formate jpg, jpeg, png.

##### Kritere Teknike për Videot:

- Videot duhet të jenë në formatin 1080\*1920 px dhe të paktën 10 sekonda.

---

#### PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS

Objekti i Minsitrisë "Rilindja", Kati i 10, Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 38 200 32611, office@unhabitat-kosovo.org

Një program i implementuar nga:



dhe i ko-financuar nga:



- Të përmbahen tematikave, duke evituar publikimin e personave apo identitetin e tyre.
- Të jenë në formate si mp4, mov.

Shtoni emrin e komunës dhe një titull ose sllogan tek Fotot dhe Videot e juaja:

- Fotot dhe videot e dorëzuara duhet të jenë të bashkangjitura me emrin e komunës të cilën e përfaqësojnë (shiko shembullin e më poshtëm).
- Fotot dhe videot e dorëzuara duhet të jenë të bashkangjitura me një sllogan të shkurtër ose titull në Shqip, Serbisht ose Anglisht (shiko shembullin e më poshtëm).

Si ti dorëzoni:

- Dërgoni fotot ose videot, së bashku me kriteret e kërkuara në e-mailin në vijim:
- Shkruani në subjekt të e-mailit: “E dua rajonin tim”
- Përfshini kategorinë (C1,C2), emrin e komunës, dhe slloganin ose titullin e fotos / videos tuaj. Kategoria 1 (C1) qëndron vetëm për konkursin e fotografisë, dhe Kategoria 2 (C2) qëndron vetëm për konkursin e videos. Shikoni më poshtë për shembullin.

*Sekuena e të emërtuarit për Kategorinë 1 [Foto1\_C1\_Komuna\_Titulli/Sllogani]*

*Shembull: Foto1\_C1\_Rahovec\_Vjelja e rrushit*

*Sekuena e të emërtuarit për Kategorinë 2 [Video1\_C2\_Komuna\_Titulli/Sllogani]*

*Shembull: Video1\_C2\_Pejë\_Ngjitja në Via Ferrata*

**REZULTATET**

Një juri e 5 anëtarëve, të përzgjedhur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe UN-Habitat Kosovo do të vlerësojnë të gjitha fotot dhe videot e pranuar. Juria do të përzgjedh tri (3) fotot dhe tri (3) videot më të mira, duke përcaktuar tri fitues nga secila kategori. Keto tri (3) foto dhe tri (3) video do të shpërblehen me çmime, shiqo më poshtë (çmimet për fituesit).

Kriteret e vlerësimit:

- Fotot dhe videot duhet të dorëzohen duke i përcjellur Kriteret Teknike të përmendura më herët (shiko më lart).
- Fotot dhe videot duhet tju bashkangjitet emri i komunës të cilën e reprezentojnë.
- Fotot dhe videot duhet tju bashkangjitet një titull ose sllogan.
- Fotot dhe videot duhet të dorëzohen në e-mailin e caktuar ([zhvillimiraajonal@rks-gov.net](mailto:zhvillimiraajonal@rks-gov.net)) sipas shembullit në vijim: **Foto1\_C1\_Rahovec\_Vjelja e rrushit.**
- Fotot dhe videot do të vlerësohen bazuar në 6 kriteret: 1. Impakti, 2. Kreativiteti, 3. Aspekti Teknik, 4. Kompozicioni, 5. Tema, 6. Tregimi / Mesazhi.

---

**PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS**

Objekti i Minsitrisë “Rilindja”, Kati i 10, Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 38 200 32611, [office@unhabitat-kosovo.org](mailto:office@unhabitat-kosovo.org)

Një program i implementuar nga:



dhe i ko-financuar nga:



### Çmimet për fituesit:

- Juria e konkursit do të shpallë 3 fitues (çmimi i parë, çmimi i dytë, çmimi i tretë) në të dy kategoritë, fotografi dhe video.
- Ne kategorinë e fotografisë, vendi i parë do të fitoj një çmim të 300 Eurove, vendi i dytë do të fitoj një çmim të 150 Eurove, dhe vendi i tretë do të fitoj një çmim të 50 Eurove.
- Ne kategorinë e videos, vendi i parë do të fitoj një çmim të 300 Eurove, vendi i dytë do të fitoj një çmim të 150 Eurove, dhe vendi i tretë do të fitoj një çmim të 50 Eurove.

Shënim: Përdorimi i fotove dhe videove të përzgjedhura, për qëllime promovuese nga Ministria e Zhvillimit Rajonal do të jetë jo ekskluziv dhe nuk ju pengon ju për t'i publikuar ato ku të dëshironi.

### **INFORMATA SHITESË:**

Për më shumë informata, ju lutem na dërgoni një e-mail në adresën në vijim:

[zhvillimirajonal@rks-gov.net](mailto:zhvillimirajonal@rks-gov.net)

---

#### PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS

Objekti i Minsitrisë "Rilindja", Kati i 10, Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 38 200 32611, [office@unhabitat-kosovo.org](mailto:office@unhabitat-kosovo.org)

*Një program i implementuar nga:*



*dhe i ko-financuar nga:*

